



KS GROUP FACTORY është një ndërmarrje e specializuar në prodhimin dhe dizajnin e produkteve të cilat i shërbejnë të gjitha nevojave tuaja të dizajnit të brendshëm. Me një përvojë të pasur në fushën e dizajnit dhe prodhimit, **KS GROUP FACTORY** është i gatshme të përmbushë vizionet tuaja për ambiente të bukura dhe të funksionale.

Veprimtaria e KS GROUP

KS GROUP është një fabrikë për orendi që ofron gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve të dizajnit të brendshëm. Veprimtaritë kryesore të KS GROUP përfshijnë:

1. Planifikimi i Hapsirës

Ekspertët tanë të dizajnit dhe arkitekturës janë të gatshëm të ndihmojnë në planifikimin e hapsirës suaj në mënyrë që të përmirësohet funksionaliteti dhe estetika.

2. Konceptimi i Ambienteve

KS GROUP kujdeset për dizajnin e ambienteve të ndryshme, duke përfshirë restorante, shkolla, bare, dhe më shumë. Ne punojmë me klientët për të krijuar ambiente unike dhe të personalizuar.

3. Interior Design

Ekspertët tanë të interior design-it janë të specializuar në krijimin e interioreve të mrekullueshme dhe të harmonizuara me stilin dhe misionin e klientëve tanë.

3. Prodhimi

Si një fabrikë, KS GROUP bën prodhimin dhe realizon të gjitha produktet e nevojshme për hapësirat e juaja nga stafi ynë i mrekullueshëm të cilët janë të përkushtuar në kualitet dhe estetikën e tyre.



Fabrika

KS GROUP FACTORY

Ne jemi të dedikuar ndaj prodhimit të produkteve të cilësisë së lartë. Përdorimi i materialeve të zgjedhura dhe teknologjiive të fundit siguron që çdo produkt që del nga fabrika jonë të jetë i qëndrueshëm dhe funksional.

Për ne, dizajni është thelbësor. Ne punojmë ngushtë me klientët tanë për të krijuar projekte të personalizuar që përputhen me stilin, shijet dhe qëllimet e tyre. Çdo produkt që prodhojmë është unik dhe dizajnuar për t'u përshtatur me ambientin ku do të përdoret.

Dallimi ndodh në detajet. Në KS GROUP FACTORY, kujdesi ndaj detajeve është i pandalshëm. Përdorimi i teknikave të përparuara të prodhimit dhe kujdesi në përfundim garantojnë që secili produkt të jetë i përsosur në çdo mënyrë.



Kuzhinat janë zemra e çdo shtëpie dhe vendi ku krijohet magjia e gatimit. Në KS GROUP FACTORY, ne kemi një pasion të veçantë për të krijuar kuzhina të personalizuar dhe të cilësisë së lartë që plotësojnë dëshirat dhe nevojat e klientëve tanë. Përmes përvojës sonë të pasur dhe aftësive të specializuara në prodhimin e kuzhinave, ne transformojmë çdo kënd të kuzhinës në një mrekulli funksionale dhe estetike.



Tavolinat janë qendër e çdo ambienti, qofshin ato në një kuzhinë të bukur, një restorant të stilizuar ose një kafene të ngrohtë. Në KS GROUP FACTORY, ne kemi një lidhje të veçantë me tavolinat dhe kujdesin për secilën detaj për t'u siguruar që ato të jenë më shumë se thjesht një sipërfaqe – ato janë vepër arti që ndryshojnë mënyrën si ndiheni në ambientin tuaj.


Për restorantet dhe kafene, ne ofrojmë një gamë të gjerë të tavolinave të dizajnuara veçanërisht për ambientin tuaj. Tavolinat tona janë të dizajnuara për të siguruar komoditet për klientët dhe për të përmirësuar eksperiencën e tyre të ngrënies. Nëse jeni në kërkim të një stili të veçantë ose dëshironi tavolina të personalizuar me logo ose detaje të tjera, ne jemi të gatshëm të ndihmojmë.

Për ambientet e kuzhinës, ne kemi një gamë të gjerë të tavolinave të cilat janë të dizajnuara për të përshtatur me stilin dhe layout-in e kuzhinës suaj. Nga tavolinat e vogla për kafe mëngjesi deri te tavolinat më të mëdha për darka dhe ngjarje të veçanta, ne kemi zgjidhjen e duhur për ju.



Ne kemi një ekip të specializuar të dizajguesve të brendshëm që janë të gatshëm të ndihmojnë në përcaktimin e pozicionimit dhe dizajnit të karrigeve në ambientin tuaj. Dizajni i drejtuar nga eksperiencia ndihmon në krijimin e një atmosfere tërheqëse dhe funksionale për klientët tuaj.

Për biznese të tilla si restorantet dhe kafenet, ne ofrojmë një gamë të gjerë të karrigave të dizajnuara për të përmbushur nevojat e klientëve tuaj. Karrigat tona janë të dizajnuara për të siguruar komoditetin dhe elegancën e duhur që ndikon në eksperiencën e klientëve.



Dekorimet janë hapat e fundit që bëjnë një projekt të dizajnit të brendshëm të ndryshojë nga çdo perspektivë. Ata janë “detaj” magjik që transformon një hapsirë të zakonshme në një ambient të mrekullueshëm dhe të personalizuar. Në KS GROUP FACTORY, ne kemi një pasion të thellë për krijimin e dekorimeve të ndryshme që pasqyrojnë temën dhe stilin e projektit tuaj.







Pjatat, tabakët dhe aksesorët për ushqim janë një pjesë e pazëvendësueshme e përvojës ushqimore në një restorant ose kafene të cilët janë të dedikuar ndaj cilësisë së lartë dhe dizajnit të sofistikuar. Në KS GROUP FACTORY, ne kemi një angazhim të thellë për krijimin e pjatave dhe aksesoreve që jo vetëm shërbejnë si mjete praktike për shërbyesit dhe klientët, por që gjithashtu shtojnë një vlerë të jashtëzakonshme estetike dhe tërheqëse në ambientin e kafenesë ose restorantit tuaj.

Çdo pjatë, tabakë dhe aksesor që prodhojmë është një vepër arti në vetvete. Ne e kemi një pasion të pashlyeshëm ndaj cilësisë së lartë dhe krijimtarisë në dizajnin tonë. Përdorimi i materialeve të larta cilësie dhe teknikave të prodhimit të përparuara sigurojnë që secila pjatë të jetë e qëndrueshme dhe e dizajnuar me kujdes.





Shkollat janë vendet ku dija dhe zhvillimi personal ndodhin çdo ditë. Në KS GROUP FACTORY, ne e kuptojmë rëndësinë e mjeteve të cilat përdoren në këto ambiente të veçanta. Për këtë arsye, ofrojmë një gamë të gjërë të mobilierisë për shkolla, duke përfshirë karriga dhe tavolina të cilat janë projektuar veçanërisht për të siguruar komoditet dhe funksionalitet në procesin mësimor.



Disa nga modele të Pjatave të drurit



Projekti për Restaurantin **Sofra**



Me angazhim dhe pasion për krijimin e ambienteve të bukura dhe funksionale, KS GROUP FACTORY është kujdesur që çdo detaj të jetë i përputhshëm me konceptin dhe stilen e restorantit “Sofra”. Përdorimi i materialeve të cilësisë së lartë dhe një dizajn i kujdesshëm kanë bërë të mundur krijimin e një ambienti të veçantë dhe tërheqës për klientët.

Shërbimet e KS GROUP FACTORY përfshijnë fazën e konceptimit, ku punuam në krijimin e një vizioni të qartë për restorantin “Sofra”, pastaj prodhimin e produkteve dhe të dekorimit të restorantit në përputhje me ndjenjën e restorantit, më në fund, ekzekutimin e punës për të sjellë në jetë ambientin e ëndrrave për restorantin “Sofra”.

Projekti për Lounge Bar **Moonlit**



Projekti i KS GROUP FACTORY për realizimin e Lounge Bar Moonlit është një dëshmi e qartë e aftësive të tyre të jashtëzakonshme në fushën e dizajnit, prodhimit dhe ekzekutimit të produkteve për ambiente të larmishme dhe të veçanta si Lounge Bar Moonlit.

KS GROUP FACTORY ka kryer një rol kyç në këtë projekt, duke filluar nga faza e konceptimit, ku ne kemi punuar ngushtë me ekipin e Moonlit për të kuptuar vizionin dhe stilin e dëshiruar të Lounge Bar Moonlit. Pas konceptimit, kemi krijuar dhe prodhuar produktet dhe të gjitha detajet e tjera të dizajnit që janë përshtatur për të plotësuar nevojat dhe preferencat e Moonlit.

Sherbimet e KS GROUP FACTORY kanë qenë të përqendruara në çdo fazë të projektit, duke siguruar që çdo produkt të jetë i dizajnuar me kujdes dhe të ketë cilësinë më të lartë. Përmes ekzekutimit të tyre të përkushtuar dhe profesionalizmit të lartë, KS GROUP FACTORY ka bërë të mundur që Lounge Bar Moonlit të jetë një ambient i mrekullueshëm dhe i veçantë, i përshtatur për të kënaqur klientët dhe për të ofruar një përvojë të pazakontë.

Projekti për Ëmbëltoren **Besniku**



Që nga konceptimi i brendshëm dhe zgjedhja e detajeve të fundit, deri te prodhimi, aranzhimi i hapsirës dhe ekzekutimi, KS GROUP FACTORY ka qenë një partner i besueshëm dhe kreativ në realizimin e Ëmbëltorës Besniku.

Konceptimi i brendshëm për Ëmbëltoren ka qenë një proces i pasionuar dhe kujdesi për të krijuar një ambient të jashtëzakonshëm dhe të personalizuar. Ekipi i KS GROUP FACTORY ka punuar ngushtë me pronarët e Ëmbëltorës për të kuptuar dhe për të pasqyruar vizionin e tyre për ambientin, duke siguruar që çdo detaj të jetë i përshtatshëm dhe i përputhshëm me identitetin dhe atmosferën që dëshirohej të krijohet.

Përzgjedhja e produkteve dhe materialeve ka qenë një tjetër aspekt i rëndësishëm i projektit. KS GROUP FACTORY ka përzgjedhur me kujdes çdo element, duke siguruar cilësi të lartë dhe një harmoni të përsosur mes elementeve të dizajnit të brendshëm.

Projekti për Lounge Bar **The Charm**



Në këtë projekt, KS GROUP FACTORY ka luajtur një rol kyç në përmirësimin dhe pasurimin e atmosferës së Lounge Bar “THE CHARM” me përzgjedhjen e karrigave dhe banakut të tyre të shkëlqyer.

Përpara se të hapet, Lounge Bar “THE CHARM” vendosi të punonte ngushtë me KS GROUP FACTORY për të siguruar që çdo element i interiorit të përputhet me vizionin dhe ndjenjën e veçantë që dëshironte të krijojë. Një pjesë e rëndësishme e kësaj ishte zgjedhja e karrigave. KS GROUP FACTORY ka ofruar një gamë të gjerë të modeleve dhe ngjyrave të karrigave, duke lejuar Lounge Bar “THE CHARM” të përzgjedhë ato që i përshatateshin më mirë atmosferës së tyre të dëshiruar.

Në shtesë tjetër është pjesa e banakut ka qenë një përzgjedhje tjetër e rëndësishme që KS GROUP FACTORY ka ndihmuar të përmirësohet vizualiteti në mënyrë të jashtëzakonshme. Ky element i dizajnit është vendosur me kujdes dhe me qëllim për të krijuar një ndjesi të veçantë dhe të harmonizojë me stilin e Lounge Bar “THE CHARM”.

Projekti për Ëmbëltoren **Missini Sweets**



Një pjesë e rëndësishme e projektit ka qenë rregullimi i detajeve vizuale. Dizajnerët e KS GROUP FACTORY kanë punuar me kujdes për të konceptuar dhe zbatuar disa pjesë të murit që të përshtateshin me identitetin dhe atmosferën e Missini Sweets. Këto pjesë të dizajnuara me kujdes kanë ndihmuar për të krijuar një ambient tërheqës dhe të personalizuar për klientët.

Zgjedhja e karrigeve dhe definimi i banakut është një aspekt tjetër kyç i projektit. KS GROUP FACTORY ka përdorur ekspertizën e tyre për të zgjedhur modele të karrigeve dhe dizajnin e banakut që të përshtateshin me estetikën e përgjithshme të ambientit të Missini Sweets. Rezultati është një kombinim i përsosur i stileve dhe funksionalitetit që i ofron klientëve një përvojë të përsosur të qëndrimit në këtë ambient të veçantë.

Projekti për Restorantin **Fish House**



Në këtë projekt, një ndjenjë e re dhe inovative është injektuar në çdo detaj të restoranit, duke e bërë atë një destinacion të pazakontë dhe tërheqës.

Një element kyç i këtij koncepti është banaku i dizajnuar në terasë me një lidhje të ngushtë me emrin e restoranit, duke përcjellë temën dhe vizionin në mënyrë të harmonizuar.

Zgjedhja e karrigeve tejet komode dhe divaneve është bërë me kujdes për të garantuar që klientët të ndihen të relaksuar dhe të kënaqur në ambientin e tyre. Rezultati është një atmosferë e larmishme, e përshtatshme për të shijuar kuzhinën shkëlqyeshëm të "FISH HOUSE", dhe për të krijuar kujtime të paharrueshme.

Projekti për Kuzhinë
Shtëpi private



Projekti i KS GROUP për kuzhinën e shtëpisë private është një shembull i shkëlqyeshëm i aftësive të tyre të dizajnit dhe inxhinierisë së përsosur. Në këtë projekt, çdo detaj ka qenë i përqëndruar me kujdes duke bërë kuzhinën të shkëlqejë me një estetikë të përsosur dhe funksion të ngulitur.

Një aspekt i veçantë i këtij projekti është përdorimi i teknologjisë CNC për të prerë detajet në kapaket e kuzhinës. Ky proces i avancuar teknologjik ka mundësuar krijimin e detajeve të ngjashme me art, duke përfshirë prerjet dhe gravimet që e bëjnë këtë kuzhinë të dalë me një pamje më unike.

Projekti për Dhomë Gjumi
Shtëpi private



KS GROUP FACTORY është i specializuar në prodhimin e dhomave të gjumit të personalizuar që përshtaten me shijet dhe stilin e secilit klient. Ne kemi pasionin dhe aftësinë për të krijuar ambiente të gjumit të jashtëzakonshme dhe të personalizuar që ofrojnë një përvojë të mrekullueshme të pushimit dhe relaksimit.

Një nga avantazhet kryesore të dhomave të gjumit të personalizuar është mundësia për të përshtatur çdo detaj në mënyrë që të reflektojë shijet dhe preferencat e klientit. Nga zgjedhja e ngjyrave dhe materialeve të kapitullimit, deri te modeli i krevatit dhe dizajni i dërrasës, çdo detaj është i kujdesur me kujdes për të krijuar një ambient të veçantë dhe unik për klientin.

Për ne, çdo projekt i dhomës së gjumit është një sfidë për të krijuar diçka të veçantë dhe të pazakontë. Ne përdorim teknologjinë dhe materialet më të cilësuar për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e çdo produkti tonë.

Projekti për Mobile
Shtëpi private



Ne e kuptojmë se mobilimi i një dhome të ndëjes është shumë më tepër se vetëm blerja e një divani ose këndi. Është krijimi i një ambiente të bukur dhe të personalizuar që të pasqyrojë stilin dhe shijet tuaja të veçanta. Për këtë arsye, ofrojmë një gamë të gjerë të mundësive për dizajnim dhe personalizim, duke përfshirë zgjedhjen e materialeve, ngjyrave, modeleve, dhe madhësisë.


Ekipi ynë i dedikuar është gati të punojë ngushtë me ju për të krijuar një divan ose këndë të cilin do ta adhuroni. Për ne, çdo projekt është një sfidë për të krijuar diçka të veçantë dhe të pazakontë, dhe ne jemi të përkushtuar që çdo produkt të jetë i përshtatshëm për hapsirën dhe për shijet tuaja.

KS GROUP FACTORY është krenar që mund të ofrojë një shërbim më të personalizuar dhe të pasur në projekte të tjera të dizajnit të brendshëm. Në bashkëpunim me brendin MF ART, ne kemi shtuar një dimension të ri të kreativitetit dhe estetikës në portofolin tonë.

Brendi MF ART është një emër i njohur në botën e qeramikës, i specializuar në krijimin e veprave të artit të personalizuar. Me artizanët e tyre të përvojshëm dhe teknologjinë e fundit, MF ART ka aftësinë të konceptojë dhe të prodhojë qeramikë të personalizuar që reflektojnë më mirë stilin dhe shijet e projekteve tuaja të ardhshme të dizajnit të brendshëm.


Këto qeramika të personalizuar mund të jenë një detaj i mrekullueshëm për çdo projekt. Ato mund të përdoren për të krijuar detaje të veçanta dhe të personalizuar në interierin e shtëpisë, restoranteve, hoteleve, dhe shumë projekte të tjera. Duke përdorur qeramikën e personalizuar nga MF ART, ju keni mundësinë të krijoni ambiente unike dhe të ndryshme që tërheqin vëmendjen dhe shkëlqejnë për shkak të detajeve të tyre të veçanta.

Ne kemi besim të plotë në cilësinë e prodhimeve të MF ART, dhe jemi të përkushtuar për të ofruar klientëve tanë zgjedhje të personalizuar dhe të pasura në projekte të ardhshme të dizajnit të brendshëm. Bashkëpunimi me MF ART është një hap në drejtim të krijimit të ambienteve të mrekullueshme dhe të personalizuar që përputhen me vizionin dhe shijet e klientëve tanë.





Arkitektura e kompanisë



Shërbimet e KS Group Factory

- 

Table
- 

Chair
- 

Living
- 

Kitchen
- 

Projects
- 

Textile



Ukë Bytyqi p.n Prizren, Kosovë
+383 44 999 441
info@ksgroupi.com
www.ksgroupi.com

 ksgroupi  Ks Group

Gjindemi edhe në Shqipëri, **Tiranë**